LIGJ
Nr. 79/2016

PËR MIRATIMIN E SHTESËS SË MARRËVESHJES SË KONCESIONIT NDËRMJET MINISTRISË SË ENERGJISË DHE INDUSTRISË, SI AUTORITET KONTRAKTUES, DHE ACR HOLDING, S.R.L., SI KONCESIONARI, PËR REHABILITIMIN, OPERIMIN DHE TRANSFERIMIN E MINIERËS SË KROMIT, BULQIZË, TË FABRIKËS SË PASURIMIT, BULQIZË, TË IMPIANTIT TË SELEKSIONIMIT, KLOS DHE TË UZINËS SË FERROKROMIT, BURREL

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet shtesa e marrëveshjes së konce-sionit ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, si autoritet kontraktues, dhe ACR Holding, s.r.l., si koncesionari, për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e Minierës së Kromit, Bulqizë, të Fabrikës së Pasurimit, Bulqizë, të Impiantit të Seleksionimit, Klos, dhe të Uzinës së Ferrokromit, Burrel, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 25.7.2016

Shpallur me dekretin nr. 9712, datë 1.8.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

SHTESË E MARRËVESHJES SË KONCESIONIT
NDËRMJET MINISTRISË SË ENERGJISË DHE INDUSTRISË, SI AUTORITET KONTRAKTUES, DHE ACR HOLDING, SI KONCESIONARI, PËR REHABILITIMIN, OPERIMIN DHE TRANSFERIMIN E MINIERËS SË KROMIT BULQIZË, TË FABRIKËS SË PASURIMIT BULQIZË, TË IMPIANTIT TË SELEKSIONIMIT KLOS DHE TË UZINËS SË FERROKROMIT BURREL

Kjo shtesë e Marrëveshjes së Koncesionit (Marrëveshje) është nënshkruar në datën 26.5.2016, ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (MEI), me adresë në bulevardin "Dëshmorët e Kombit", nr. 1, Tiranë, Shqipëri (këtu e më poshtë referuar si "Autoriteti Kontraktues"), përfaqësuar nga z. Damian Gjiknuri, ministër i Energjisë dhe Industrisë dhe ACR Holding s.r.l., një shoqëri e së drejtës italiane, me seli të shoqërisë në Milano, Itali, përfaqësuar nga z. Eglant Pupa, administrator i ACR Holding s.r.l. (këtu e më poshtë referuar si "Koncesionari"). Secili prej Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit do të quhen individualisht "Pala" dhe bashkërisht "Palët",

Meqenëse:

A. Ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit (MEPP) dhe "Darfo" s.p.a., në datën 14.4.2001, është firmosur një marrëveshje koncesioni e formës ROT (Marrëveshja e Koncen-sionit), e cila më pas u miratua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr. 8791, datë 10.5.2001, "Për miratimin e marrëveshjes së koncesionit të formës ROT të Minierës së Kromit Bulqizë, të Fabrikës së Pasurimit Bulqizë, të Impiantit të Seleksionimit Klos dhe të Uzinës së Ferrokromit Burrel, ndërmjet Ministrisë së

Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe shoqërisë së të drejtës italiane "Darfo" s.p.a., si dhe dhënies së disa stimujve dhe garancive për Koncesionarin e kësaj Marrë-veshjeje";

B. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e ka shpallur si sektor të rëndësishëm sektorin minerar dhe kërkon që të vitalizojë investimet në këtë sektor;

C. Në vitin 2005, shoqëria "Darfo" s.p.a. u shndërrua nga shoqëri aksionare në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "Darfo" s.r.l.;

Ç. Në vitin 2010, "Darfo" s.r.l. ndryshoi emërtimin në ACR Holding s.r.l.;

D. Në vitin 2013, Balfin Group bleu 100% të kuotave të shoqërisë ACR Holding s.r.l. si mbajtëse e të drejtave dhe detyrimeve të kontratës së koncesionit;

Dh. Ministria e Energjisë dhe Industrisë është ministria përgjegjëse për sektorin minerar dhe Autoritet Kontraktues në lidhje me koncesionet në këtë sektor;

E. Balfin Group, nëpërmjet Koncesionarit dhe shoqërisë koncesionare Albchrome sh.p.k., në periudhën kohore 2013–2015, ka investuar rreth 11,5 milionë USD;

Ë. Palët njohin faktin se që nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Koncesionit dhe deri në nën-shkrimin e kësaj Marrëveshjeje, kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme në legjislacionin që lidhen me kontratat e koncesionit, si dhe në atë minerar dhe se është e domosdoshme që bashkëpunimi mes Palëve të marrë në konsideratë këto ndryshime;

F. Palët njohin dhe pranojnë faktin që për një shfrytëzim optimal dhe eficient të burimeve minerale të dhëna në koncesion, është i nevojshëm përditësimi, shtimi dhe/ose ndryshi-mi i investimeve dhe prioriteteve të këtyre investimeve të përcaktuara fillimisht në Marrë-veshjen e Koncesionit; si dhe

G. Shoqëria koncesionare Albchrome sh.p.k., është pajisur me lejen minerare nr. 677, datë 16.9.2002, të ndryshuar, së fundmi i ndryshuar me urdhrin nr. 234, datë 30.6.2014, të ministrit të Energjisë dhe Industrisë, ku përcaktohen, ndërmjet të tjerave, dhe koordinatat dhe kuotat e pikave kufizuese të sipërfaqes së zonës së lejuar minerare.

Bazuar mbi kushtet, të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Interpretimi

Përveçse kur ndryshohen shprehimisht nga kjo Marrëveshje, dispozitat e Marrëveshjes së Koncesionit do të vazhdojnë të jenë në fuqi me efekt të plotë dhe detyrues për Palët.

Kjo Marrëveshje bëhet pjesë e Marrëveshjes së Koncesionit dhe kudo ku përdoret termi "Marrëveshje Koncesioni" do të konsiderohet se ky term përfshin edhe këtë Marrëveshje.

Neni 2

Përkufizimet

Në nenin 1 të Marrëveshjes së Koncesionit, "Përkufizimet", bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Përkufizimi "Koncesionari", ndryshon si më poshtë:

"Koncesionari" ka kuptimin që i është dhënë në këtë Marrëveshje.

Përkufizimi "Forcë madhore", ndryshon si më poshtë:

"Forcë madhore" do të thotë çdo rrethanë që rezulton ose shkakton pamundësi të plotë ose të pjesshme të njërës Palë (Pala e Cenuar) për të përmbushur ndonjë prej detyrimeve të saj sipas Marrëveshjes së Koncesionit (përveç kryerjes së pagesave të parave), por vetëm nëse dhe në masën që:

a) kjo rrethanë, pavarësisht ushtrimit të kujdesit të arsyeshëm, nuk mund të parandalohet ose nuk ishte e mundur të parandalohej, shmangej ose mënjanohej nga Pala e Cenuar;

b) Pala e Cenuar mori ose ka marrë të gjitha masat e arsyeshme paraprake, kujdesin e duhur dhe masa të arsyeshme alternative, në mënyrë që të shmangte pasojën e këtij rasti në aftësinë e Palës së Cenuar për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje Koncesioni dhe për të zbutur pasojat e saj;

c) ngjarja nuk është ose nuk ka qenë pasojë e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e shkeljes nga Pala e Cenuar të një prej detyrimeve të saj sipas Marrëveshjes së Koncesionit; dhe

d) Pala e Cenuar t'i ketë dhënë njoftim Palës tjetër për këtë rast të forcës madhore.

Pa kufizuar frymën e përgjithshme të paragrafit më sipër, secila nga rrethanat e mëposhtme, në masën që është në përputhje me kriteret e përcaktuara në paragrafët më sipër, do të përbëjë rast të forcës madhore:

a) veprimet e luftës, pushtimi ose aktet e një armiku të huaj, ose akte të terrorizmit, bllokadat, embargot, racionimet;

b) akte të rebelimeve, kryengritjet, trazirat civile, grevat e natyrës politike, aktet ose fushatat e terrorizimit, ose sabotazhi me natyrë politike apo të çdolloj natyre tjetër;

c) rrufeja, zjarri, tërmeti, stuhia, cikloni, tajfuni, tornado ose ndonjë fatkeqësi tjetër natyrore;

d) epidemia; dhe

e) grevat ose veprimtaritë për të ndaluar dhe/ose për të ngadalësuar punën.

Përkufizimi "Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA)", ndryshon si më poshtë:

"Autoriteti Kontraktues" është ministria përgjegjëse për veprimtarinë minerare dhe që legjislacioni në fuqi e ka autorizuar të jetë si palë për efekt të kësaj Marrëveshjeje dhe të zbatimit të Marrëveshjes së Koncesionit;

Kudo ku në Marrëveshjen e Koncesionit është përdorur termi "Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA)", do të zëvendësohet nga termi "Autoriteti Kontraktues".

Përkufizimi "Palët", ndryshon si më poshtë;

"Palët" ka kuptimin që i është dhënë në hyrje të kësaj Marrëveshje.

Përkufizimi "Periudha e koncesionit", ndry-shon si më poshtë:

"Periudha e Koncesionit" ka kuptimin që i është dhënë në nenin 8 të Marrëveshjes së Koncesionit.

Pas përkufizimit "Shoqëri koncesionare" shtohen përkufizimet e mëposhtme:

"Marrëveshje" ka kuptimin që i është dhënë në hyrje të Marrëveshjes.

"Ditë pune" do të thotë dita në të cilën Banka e Shqipërisë është e hapur për punë, përjashtuar të shtunën, të dielën dhe festat zyrtare.

"Plani i ri i investimeve" do të thotë investimet e reja që do të kryhen nga Koncesionari dhe që specifikohen në aneksin nr. 2, i cili do të zëvendësojë anekset 2 dhe 3 të Marrëveshjes Koncesionare.

"Raporti i Progresit", do të thotë dokumenti i përgatitur çdo vit nga Koncesionari dhe i miratuar nga Autoriteti Kontraktor, ku paraqitet ecuria e investimeve të realizuara gjatë vitit, investimet e parealizuara, shkaqet e mosrealizimit të tyre, propozimet për ndryshimet e zërave dhe/ose vlerave të investimeve të parashikuara për t'u realizuar nga Koncesionari, si dhe masat që duhet të ndërmarrin Palët për kryerjen e investimeve gjatë vitit/eve në vazhdim.

"Objekt i Koncesionit" do të thotë objektet dhe/ose asetet e përmendura në nenin 2 të Kontratës së Koncesionit, si dhe në aneksin nr. 1, i ndryshuar.

"Financuesit e Projektit" do të thotë çdo person apo persona që financojnë apo rifinancojnë borxhe (hua) të Koncesionarit apo/dhe shoqërisë koncesionare, në lidhje me Projektin.

"Person" do të thotë çdo individ, person fizik apo shoqëri tregtare, e themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar, ndërmarrje, institucion publik i pushtetit qendror, vendor apo i pavarur (në çdo rast, me ose pa personalitet juridik të veçantë).

Neni 3

Kriteret specifike të punimeve

Neni 3.1 i Marrëveshjes së Koncesionit, "Kriteret specifike të punimeve", ndryshohet si më poshtë vijon:

A. Në Minierën e Bulqizës do të realizohen këto investime:

1. Zhvillimi i pjesës veriore, hapja në thellësi, pusi nr. 9;
2. Zhvillimi i vendburimit të Qafë-Buallit;
3. Hapja e tranberbankut të Klosit.

B. Në Uzinën e Ferrokromit Burrel do të realizohen këto investime:

1. Rikonstruksioni i furrës ekzistuese;
2. Ndërtimi i një furre të re në UFK Burrel.

Në total, brenda 8 (tetë) viteve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, në pjesën veriore të Minierës së Bulqizës, Sektorin Qafë-Bualli dhe Uzinën e Ferrokromit Burrel, parashikohet të investohen rreth 24,214,505 USD, sipas specifikimeve, kushteve dhe shpërndarjes së dhënë në aneksin 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3.2 i kontratës së koncesionit, ndryshon si më poshtë:

"Koncesionari do të marrë masat që të vërë në zbatim/implementojë brenda periudhës së pritshme, prej 8 (tetë) vitesh nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje (Periudha e investimeve), shumën e investimeve të

përshkruara në planin e ri të investimeve, duke marrë parasysh tregun dhe kushtet tregtare në Shqipëri apo në tregjet ndërkombëtare.

Për efekt të llogaritjes dhe të kontrollit të vazhdueshëm të investimeve të detajuara në aneksin 2 (përfshirë dhe ndryshimet që palët mund t'i bëjnë këtij aneksi në përputhje me këtë Marrëveshje), periudha e investimeve do të ndahet në tri faza: i) faza e parë do të jetë periudha trevjeçare, duke filluar nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje (në vijim "faza e parë e investimeve"); ii) faza e dytë do të jetë periudha trevjeçare, duke filluar nga dita e parë pas përfundimit të fazës së parë të investimeve (në vijim "faza e dytë e investimeve"); si dhe iii) faza e tretë do të jetë periudha dyvjeçare, duke filluar nga dita e parë pas përfundimit të fazës së dytë të investimeve ("faza e tretë e investimeve" dhe së bashku me fazën e parë të investimeve dhe fazën e dytë të investimeve, në vijim "fazat e investimeve").

Nëse Koncesionari ka bërë më shumë investime se sa është parashikuar në aneksin 2, për një fazë investimi dhe këto investime janë konfirmuar nga raportet e progresit të miratuara vjetore, atëherë teprica e këtij investimi do t'i llogaritet si investim i bërë në fazën pasardhëse. Nëse Koncesionari ka bërë më pak investime se sa është parashikuar në aneksin 2, për një fazë investimi dhe kjo është e konfirmuar nga raportet e progresit të miratuara vjetore, atëherë Koncesionari do t'i paguajë Autoritetit Kontraktues si kusht penal vlerësues, një shumë (e referuar më poshtë si një "shumë penaliteti"), që llogaritet duke aplikuar përqindjen përkatëse të përcaktuar më poshtë, mbi totalin e miratuar të investimeve për fazën e investimit përkatëse minus çdo shumë të investuar konkretisht nga ana e Koncesionarit (dhe të konfirmuar nga raportet e progresit të miratuara vjetore) për atë fazë. Diferenca ndërmjet totalit të miratuar të investimeve për një fazë investimesh dhe investimeve aktuale për atë fazë do të referohet si investimi i munguar. Shuma e penalitetit do të jetë e barabartë me 10% të investimit të munguar.

Çdo shumë penaliteti do të paguhet nga Koncesionari Autoritetit Kontraktues në përfundim të çdo faze investimesh, brenda 2 (dy) muajve nga kërkesa me shkrim që i dorëzohet Koncesionarit, për këtë qëllim, duke përfshirë dhe një detajim të hollësishëm për llogaritjen, sipas raportit të progresit në përputhje me parashikimet e këtij neni.

Nëse pagesa nuk ndodh brenda periudhës 2-mujore sipas paragrafit më sipër, Koncensionari do t'i paguajë Autoritetit Kontraktues një kamatëvonesë, të barabartë me kamatëvonesën ligjore të përcaktuar sipas legjislacionit shqiptar.

Pavarësisht nga sa më sipër, nëse investimet e planifikuara në aneksin 2 të kësaj Marrëveshjeje, nuk janë kryer në kohë për shkak të forcës madhore dhe për sa kohë zgjat efekti i kësaj force madhore apo për shkak të një mospërmbushjeje të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, atëherë Koncesionari nuk do të jetë i detyruar të paguajë asnjë shumë penaliteti ndaj Autoritetit Kontraktues.

Për shmangien e çdo dyshimi, pagesa e shumës së penalitetit për çdo fazë investimesh përfaqëson shpërblimin e dëmit dhe detyrimin e vetëm që ka Koncesionari ndaj Autoritetit Kontraktues për mospërmbushjen e detyrimit të tij sipas Marrëveshjes së Koncesionit në lidhje me mospërmbushjen e tij për kryerjen e investimeve.

Palët bien dakord që çdo mosmarrëveshje në lidhje me përcaktimin e shumës së penalitetit dhe/ose pagesën e saj do të zgjidhet sipas nenit 21 të Marrëveshjes së Koncesionit.".

Neni 4

Koha e fillimit të punimeve

Në nenin 4 të Kontratës së Koncesionit, pas paragrafit 4.2 shtohet paragrafi 4.3 me këtë përmbajte:

"4.3 Punimet e përcaktuara në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje, fillojnë dhe kryhen në përputhje me grafikun e planit të ri të investimeve, i cili është parashikuar në aneksin 2 të kësaj Marrëveshjeje.".

Neni 5

Detyrimet e Koncensionarit

Në nenin 5 të Marrëveshjes së Koncensionit, paragrafi 5.3 ndryshon si më poshtë:

"5.3 Të respektojë të drejtën e Autoritetit Kontraktor për ruajtjen e pronësisë së mjeteve kryesore (inventarit) të marra në koncension, për sa kohë ato nuk janë nxjerrë jashtë përdorimi apo bërë të pamundura për t'u rikuperuar nga Koncensionari.

Pavarësisht kësaj, Koncesionari ka detyrimin për të dorëzuar në gjendje pune dhe në pronësi të Autoritetit Kontraktues, çdo mjet kryesor (inventarit) të marrë në koncension që Koncen-sionari ka zëvendësuar, rehabilituar, përmirësuar gjatë kohëzgjatjes së Marrëveshjes së Koncen-sionit, duke pasur

parasysh, gjithashtu, amortizimin që këto mjete kanë pësuar që nga koha e zëvendësimit, rehabilitimit apo përmirësimit.

Koncensionari në rastin e zëvendësimit, rehabilitimit, rikuperimit, nxjerrjes jashtë përdori-mi të mjeteve kryesore (inventarit) të marra në koncension, njofton Autoritetin Kontraktues.

Koncensionari, me miratim të Autoritetit Kontraktues, mund të transferojë pjesë nga mjetet kryesore (inventarit) të marra në koncension dhe që nuk i shërbejnë më qëllimit të koncensionit, një personi të tretë publik, duke respektuar procedurat ligjore që kërkon Autoriteti Kontratues, si dhe duke e shoqëruar këtë transferim me dokumentacionin përkatës ligjor".

Neni 6

Detyrimet e Autoritetit Kontraktues

Në nenin 6 të Marrëveshjes së Koncesionit, pas paragrafit "f" shtohen paragrafët "g", "h" dhe "i" me këtë përmbajtje:

"g) Autoriteti Kontraktues, brenda kompeten-cave të tij ligjore do të pajisë Koncensionarin me të gjitha lejet, licencat, autorizimet dhe me çdo akt tjetër, në përgjegjësi të tij, të nevojshëm për zhvillimin e aktivitetit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së Marrëveshjes Koncensionare dhe do të bëjë në kohë ripërtëritjen, zëvendësimin, zgjatjen e lejeve, licencave apo autorizimeve që ekzistojnë në momentin e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje, me kusht që Koncensionari të ketë dorëzuar në kohë dhe konform legjislacionit shqiptar të gjithë dokumentacionin e kërkuar, në formën dhe në përmbajtjen e kërkuar. Autoriteti Kontraktues nuk do t'i shfuqizojë, revokojë apo bëjë të pavlefshme këto leje, autorizime apo licenca gjatë gjithë kohëzgjatjes së Marrëveshjes Koncensionare apo të vendosë detyrime të tjera shtesë ndaj Koncensionarit për marrjen, zgjatjen, ripërtëritjen, vlefshmërinë e këtyre lejeve, licencave, autorizimeve apo çdo akt/veprim tjetër, si kusht për të kryer njërën, disa apo të gjitha nga veprimet/aktet e përmendura në këtë paragraf, me kusht që Koncensionari të ketë respektuar kërkesat që ka legjislacioni shqiptar për këto leje, licenca, autorizime.

h) Autoriteti Kontraktues do të asistojë, në institucionet përgjegjëse, Koncesionarin për pajisjen me çdo leje, licencë, autorizim tjetër të nevojshëm për aktivitin koncesionar gjatë gjithë kohëzgjatjes së koncesionit.

i) Autoriteti Kontraktues, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Marrëveshjen e Koncesionit, do të mbajë të padëmtuar Konce-sionarin nga çdo pasojë që i vjen këtij të fundit nga dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur ndonjë nga detyrimet e tij sipas nenit 6 të Marrëveshjes së Koncesionit dhe në përgjithësi nga dështimi i tij për të përmbushur ndonjë nga detyrimet e tij të shprehura në Marrëveshjen e Koncesionit, këtë Marrëveshje dhe/ose detyrimet e tij sipas legjislacionit.".

Neni 7

Miratimi i planit të investimit

Në nenin 7 të Marrëveshjes së Koncesionit, "Vlerësimi i investimit", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Titulli i nenit 7, ndryshon nga "Vlerësimi i investimit", në "Miratimi i planit të investimeve".

Paragrafi 7.2 i nenit 7 të Marrëveshjes së Koncesionit, ndryshohet si më poshtë vijon:

"7.2 Brenda datës 31 të muajit mars të çdo viti, Koncesionari i paraqet Autoritetit Kontraktues raportin e progresit në të cilin paraqet ecurinë e investimeve të vitit paraardhës, si dhe ecurinë progresive të investimeve nga fillimi i planit të ri të investimeve deri në fundin e vitit paraardhës. Raporti i progresit shoqërohet me shpjegime të hollësishme për investimet e realizuara, investimet e parealizuara, arsyet e mosrealizimeve nëse ka, masat që do të ndërmarrë Koncesionari për realizimin e investimeve që nuk janë kryer gjatë vitit paraardhës, veprimet që kërkohen të ndërmerren nga Autoriteti Kontraktues në përmbushje të detyrimeve të tij kontraktuale dhe/ose ligjore, nevojat për investime të reja, nevojat për ndryshime të zërave të investimeve.".

Pas paragrafit 7.2 shtohen paragrafët 7.3, 7.4, 7.5 dhe 7.6 me këtë përmbajtje:

7.3 Brenda 2 javëve nga marrja e raportit të progresit, personat e autorizuar të Palëve, nëse është nevoja, shqyrtojnë së bashku raport-progresin, si dhe për masat që duhen marrë nga Palët për zbatimin e këtij plani të ri të investimeve gjatë vitit/eve në vazhdim.

7.4 Diskutimet për planin e investimeve të vitit ushtrimor, përfundojnë brenda 2 javëve nga takimi i parë sipas paragrafit 7.3 më sipër dhe, në çdo rast, jo më vonë se 60 ditë kalendarike nga dita e paraqitjes së raportit të progresit.

7.5 Palët evidentojnë në një dokument të firmosur nga ato (Palët) masat që duhet të ndërmerren nga Palët për zbatimin e planit të ri të investimeve gjatë vitit/eve në vazhdim.

7.6 Nëse Koncesionari konstaton se për shkak të ndryshimit të rrethanave është e nevojshme ndryshimi i planit të ri të investimeve, ai i paraqet, në formë të shkruar, Autoritetit arsyet dhe nevojat e këtij ndryshimi, si dhe investimet që ai mendon se duhen ndryshuar. Procedurat, format dhe afatet e paraqitjes dhe diskutimit të ndryshimeve në planin e ri të investimeve, janë të njëjta me ato të përshkruara në paragrafët 7.3, 7.4 dhe 7.5 më sipër. Vlera e pakësimit të investimit, nëse është e nevojshme, nuk do të jetë më shumë se 10% të vlerës të investimeve, të specifikuar në nenin 3.1 të kësaj Marrëveshjeje.

7.7 Nëse Palët arrijnë një marrëveshje për ndryshimin e planit të ri të investimeve, kjo Marrëveshje evidentohet në formë të shkruar (në formën e një dokumenti të firmosur nga të dyja palët). Ky dokument ka fuqi detyruese për Palët dhe bëhet pjesë e Marrëveshjes së Koncesionit.

7.8 Nëse Palët nuk arrijnë një marrëveshje për ndryshimin e planit të ri të investimeve sipas parashikimeve të paragrafëve 7.6 dhe 7.7 më sipër, Koncesionari, për aq sa është e mundur, do të vazhdojë me implementimin e planit të ri të investimeve sipas parashikimeve të aneksit nr. 2.".

Neni 8

Periudha e koncesionit

Neni 8.1 i kontratës së koncesionit ndryshon si më poshtë:

"8.1 Periudha e koncesionit përfundon më 31 dhjetor 2040.".

Neni 8.2, shfuqizohet.

Neni 9

Mbështetja për projektin

Në nenin 10 të kontratës së koncesionit, "Mbështetja për projektin", paragrafi 10.2 i nenit 10 të kontratës së koncesionit, ndryshohet si më poshtë vijon:

"10.2 Autoriteti Kontraktor bëhet garant që TVSH-ja do të rimbursohet rregullisht, brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim të TVSH-së nga ana e shoqërisë koncesionare.".

Neni 10

Transferimi dhe garancitë

Me përjashtim kur është parashikuar ndryshe në Marrëveshjen e Koncesionit apo/dhe në këtë Marrëveshje, Koncesionari nuk mundet të transferojë, pjesërisht apo tërësisht, apo të vendosë barrë, peng, hipotekë, mbi të gjithë apo një pjesë të objekteve të koncesionit, ekzistuese apo të krijuara, dhe/ose të gjitha apo një pjesë të të drejtave dhe detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së Koncesionit dhe/ose kësaj Marrëveshjeje, pa miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

Koncesionari ka të drejtë që pas marrjes së miratimit me shkrim të Autoritetit Kontraktues dhe nëse kjo kërkohet nga financuesit e projektit dhe vetëm për qëllim të financimit të projektit, të vendosë barrë mbi objektet e koncensionit, përfshi dhe kuotat/aksionet e shoqërisë koncesionare, të vendosë hipotekë mbi asetet ekzistuese që përbëjnë objektin e koncesionit apo ato të krijuara, apo të transferojë në ndonjë mënyrë tjetër të drejtat apo/dhe interesat e tij në lidhje me projektin, me qëllim vendosjen e garancive në favor të financuesve të projektit.

Koncesionari nuk mundet që pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues, të transferojë, pjesërisht apo tërësisht, Marrëveshjen e Koncesionit te një palë e tretë. Palët bien dakord që miratimi me shkrim i Koncesionarit duhet të jepet brenda 15 ditëve kalendarike nga kërkesa e Koncesionarit, e shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm për identifikimin e palës së tretë dhe se një miratim i tillë nuk mund të refuzohet nga Autoriteti Kontraktues në mënyrë të paarsyeshme. Për hir të sqarimit, do të konsiderohet se refuzimi është i paarsyeshëm nëse pala e tretë së cilës propozohet t'i transferohet Marrëveshja e Koncesionit, ka të paktën të njëjtat karakteristika teknike dhe/ose financiare me Koncesionarin. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kërkojë informacion shtesë në çdo moment. Gjatë kësaj kohe afatet konsiderohen të pezulluara. Nëse Autoriteti Kontraktues dështon të japë një përgjigje për kërkesën brenda afatit 15-ditor, atëherë Palët bien dakord se kërkesa do të konsiderohet e miratuar në heshtje nga ana e tij (Autoritetit Kontraktues).

Neni 11

Amendimet dhe ndryshimet

Në nenin 20 të Marrëveshjes së Koncesionit, pas paragrafit të fundit të këtij neni shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Marrëveshja e Koncesionit dhe asnjë prej neneve të saj, nuk mund të ndryshohet, hiqet dorë, amendohet, përveçse kur ka një marrëveshje me shkrim ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit. Një marrëveshje e tillë bëhet efektive: a) me miratimin e saj nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në rastet kur parashi-kohen ndryshime, amendime, heqje dorë nga nenet 8, 10, neni 11, neni 16 dhe neni 17, të Marrëveshjes së Koncesionit; b) me miratimin e saj nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë kur parashikohen ndryshime, amendime, heqje dorë nga nenet 5 dhe 6 të Marrëveshjes së Koncesionit; dhe c) në të gjitha rastet e tjera, përfshirë dhe anekset e Marrëveshjes së Koncesionit me firmosjen e saj nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 12
Veçueshmëria

Pas nenit 20 të Marrëveshjes së Koncesionit, shtohet neni 20/1 me këtë përmbajte:

"Neni 20/1
Veçueshmëria

Nëse ndonjë kusht apo nen i kësaj Marrëveshjeje dhe/ose Marrëveshjes së Konce-sionit në tërësi, rezulton apo shpallet i pavlefshëm, i paligjshëm, i pazbatueshëm, nenet dhe kushtet e tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe/ose Marrëveshjes së Koncesionit në tërësi, mbeten të pacenuara.".

Neni 13
Marrëveshja e plotë

Kjo Marrëveshje është nënshkruar në dy kopje dhe secila ka të njëjtën vlerë. Kjo Marrëveshje është marrëveshja përfundimtare dhe ekskluzive midis Palëve në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshjeje dhe tejkalon çdo negociatë apo marrëveshje me shkrim apo verbale ndërmjet Palëve.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje, hyn në fuqi pas nënshkrimit të saj dhe hyrjes në fuqi të ligjit që do ta miratojë atë.

Për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë
Z. Damian Gjiknuri

Për shoqërinë ACR Holding s.r.l.
Z. Eglant Pupa

ANEKSI 2
MARRËVESHJES SË KONCESIONIT - PLANI I INVESTIMEVE

A. Planifikimi dhe realizimi i investimeve (USD)

Objektet për t'u investuar - koncesioni fillestar	Investimet sipas Marrëveshjes Koncesionare	Realizimi deri më 31.12.2012	Realizimi nga koncesio-nari i ri, në periudhën 1.1.2013 - 31.6.2015	Realizimi total deri më 31.6.2015 E=(D+F)	Investime për të plotësuar shifrat e parashikuara në Marrëveshjen Koncesionare	Investime në vlerë për të plotësuar zërat e parashikuar në natyrë në Marrëveshjen Koncesionare	Investime të planifikuara mbi vlerat e parashikuara në Marrëveshjen Koncesionare	Investimi në total, sipas Marrëveshjes së Amenduar
	(C)	(D)	(F)	(E)	(G = C-E)	(H)	(I)	(J = H + I)
Miniera e Kromit Bulqizë	$11,500,000	$ 11,643,333	$ 9,894,738	$ 21,538,071	$ (10,038,071)	5,563,000	$23,389,718	$28,952,718
UFK Burrel	$ 7,200,000	$ 1,385,203	$ 658,036	$ 2,043,239	$ 5,156,761	5,814,797	$0	$5,814,797
FPK Bulqizë	$ 1,800,000	$ 3,824,189	$ 230,643	$ 4,054,832	$ (2,254,832)	$0	$0	$0
Imp. Seleks. Klos	$ 100,000	$ 524,427	$ 725,761	$ 1,250,188	$ (1,150,188)	$0	$0	$0
Shuma	**$ 20,600,000**	**$ 17,377,152**	**$ 11,509,178**	**$ 28,886,330**	**$ (8,286,330)**	**11,377,797**	**$23,389,718**	**$34,767,515**

B. Plani i ri i investimeve sipas zërave dhe viteve (USD)

	Plan i investimeve	Sasia e investimit	Realizuar 1.1.2013 - 30.6.2015	Mbetur për t'u investuar	Faza 1			Faza 2			Faza 3	
					Viti I	Viti II	Viti III	Viti IV	Viti V	Viti VI	Viti VII	Viti VIII
	MINIERA E KROMIT BULQIZË	**28,952,718.00**	**9,894,974.00**	**19,057,744.00**	**4,485,185.00**	**2,690,963.00**	**2,326,317.00**	**4,103,708.00**	**2,961,811.00**	**1,250,000.00**	**739,760.00**	**500,000.00**
	(pjesa veriore)	**21,732,718**	**9,279,002**	**12,453,716**	**4,105,185**	**2,490,963**	**2,126,317**	**1,651,251**	**580,000**	**500,000**	**500,000**	**500,000**
1	Investime për hapjen e traverbankut të Klosit dhe infrastrukturës përkatëse	3,482,718	451,467	3,031,251	800,000	800,000	800,000	631,251				
2	Investime për punime kapitale (P9-Niv 5-21) dhe anekset	9,600,000	6,019,037	3,580,963	2,980,000	600,963						
3	Investime makineri e pajisje	2,500,000	913,683	1,586,317	100,000	500,000	686,317	300,000				
4	Investime për punime kapitale në nivele	4,400,000	1,458,343	2,941,657	141,657	400,000	400,000	400,000	400,000	400,000	400000	400000
5	Investime për ajrimin	400,000	227,589	172,411	32,411	40,000	40,000	30,000	**30,000**			
6	Investime të tjera (remonte											

	kapitale pusesh etj.)	550,000	204,908	345,092	45,092	100,000	100,000	50,000	50,000			
7	Investimet përpunime gjeologo-zbuluese	800,000	3,975	796,025	6,025	50,000	100,000	240,000	100,000	100,000	100000	100000
	(Sektori Qafë e Buallit)	**7,220,000**	**615,972**	**6,604,028**	**380,000**	**200,000**	**200,000**	**2,452,457**	**2,381,811**	**750,000**	**239,760**	**-**
8	Për punime kapitale rikonstruk-sione etj.	2,500,000	260,240	2,239,760				**400,000**	**1,500,000**	**300,000**	39,760	
9	Ndërtim, montime e sistemime	430,000	116,804	313,196				**200,000**	**113,196**			
10	Makineri e pajisje mekanike	2,410,000	207,543	2,202,457				**1,202,457**	**400,000**	**400,000**	200000	
11	Makineri e pajisje elektrike	750,000	31,385	718,615				**400,000**	**318,615**			
12	Të paparashikuara	150,000	-	150,000				**50,000**	**50,000**	**50,000**		
13	Investime për punime gjeologjike	980,000	-	980,000	**380,000**	**200,000**	**200,000**	**200,000**				
	UZINA E FERROKROMIT BURREL	**5,814,797.00**	**658,036.00**	**5,156,761.00**	**300,000.00**	**2,100,000.00**	**2,200,000.00**	**556,761.00**	**-**	**-**	**-**	**-**
14	Rikonstruksion i furrës ekzistuese	658,036	658,036	**-**								
15	Ndërtimi i një furre të re dhe infrastruktura ndihmëse	5,156,761	-	**5,156,761**	**300,000**	**2,100,000**	**2,200,000**	**556,761**				
	INVESTIME TOTAL	**34,767,515**	**10,553,010**	**24,214,505**	**4,785,185**	**4,790,963**	**4,526,317**	**4,660,469**	**2,961,811**	**1,250,000**	**739,760**	**500,000**

Shënim.

1. Ky aneks do të zëvendësojë aneksin 2 ("Plani i investimeve") dhe 3 ("Cash Flow") të Marrëveshjes së Koncesionit.

2. Palët njohin dhe pranojnë se investimet në sektorin e Qafë-Buallit do të bëhen vetëm nëse pas përfundimit të fazës së parë të projektit të shpimeve gjeologjike (zëri 13), rezulton se rezervat e nxjerrshme të mineralit të kromit vërtetohen të jenë të paktën 603,000 tonë krom të cilësisë mesatare mbi 36% Cr_2O_3.

3. Viti 1 konsiderohet periudha 1 korrik 2015–deri 30.12.2016.

4. Shembull i përllogaritjes së investimeve dhe shumës së penalitetit: Thjesht për efekt qartësimi të formulës së përdorur në nenin nr. 3.2 të Marrëveshjes së Koncesionit, llogarisim se investimi i parashikuar për secilën fazë investimesh është parashikuar 10 milionë euro. Në fazën e parë të investimeve, Koncesionari investon 9 milionë euro. Në fund të fazës së parë të investimeve, Koncesionari do të paguajë shumën e penalitetit prej 100,000 mijë eurosh (10% x investimin e munguar (10 milionë - 9 milionë = 1 milion). Në fazën e dytë të investimeve, Koncesionari investon 12 milionë euro. 2 milionë euro të investuara më tepër se investimi i parashikuar për fazën e dytë të investimeve, do të mbarten në fazën e tretë të investimeve. Në fazën e trete të investimeve, Koncesionari do të investojë 8 milionë euro, të cilat, së bashku me 2 milionë eurot e investuara dhe të mbartura nga faza e dytë e investimeve, përmbushin detyrimin për investim në fazën e tretë të investimeve.